



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 280, Datë 25.09.2023

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PEZULLIMIN DHE RIVENDOSJEN E
AKTIVITETIT TË TREGUT, RREGULLAVE PËR SHLYERJEN E DISBALANCEVE,
KAPACITETIT BALANCUES DHE ENERGJISË BALANCUESE, PËR PERIUdhËN
GJATË SË CILËS AKTIVITETET E TREGUT JANË PEZULLUAR”**

Në mbështetje të neneve 16, 19 dhe 62 pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Pjesës IV, nenit 278 të “Kodit të Transmetimit” të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 63, datë 11.04.2022 si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.09.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1363/6 prot., datë 20.09.2023 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”,

Konstatoi se:

- OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 2974 prot., datë 28.04.2023, të protokolluar në ERE me nr. 1363 prot., datë 04.05.2023, ka përcjellë kërkesën për miratim të rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 180, datë 29.05.2023 vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e rregullave “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.
- ERE nëpërmjet shkresës nr. 1363/4 prot., datë 01.06.2023, njoftoi këto palë interesi për vendimin nr. 180/2023: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin e Konkurrencës (AK), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., Furnizuesin e Tregut

të Lirë (FTL) sh.a., Furnizuesin të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a., Kurum International sh.a., Devoll Hydropower sh.a., AYEN AS ENERGIJI sh.a., Energji Ashta sh.p.k., shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AREA), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, shoqatën për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe Tregut, shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Konsumatori në Fokus.

- Me qëllim një konsultim sa më të gjerë të këtij akti u realizua dhe publikimi i tij në faqen zyrtare të internetit të ERE-s me datë 28.04.2023, në rubrikën konsultime.
- Kjo rregullore është e përbërë nga 16 nene të cilat përcaktojnë elementet e nevojshëm për pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.
- Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 311/2, datë 13.07.2023, të protokolluar në ERE me nr. 1363/5, datë 17.07.2023, ndër të tjera parashtron si më poshtë vijon: *Kjo procedurë është zhvilluar në mbështetje të neneve 16, 19 dhe 62, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjise elektrike", "Kodit të Transmetimit" i miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 63, datë 11.04.2022; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016. Nga vlerësimi i vendimit konstatohet se procedura më sipër nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".*
- AAES që në momentin e ardhjes së propozimit nga OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 6/1 prot, datë 09.05.2023, parashtron si më poshtë vijon:
*...Duke konsideruar pezullimin e tregut të energjisë elektrike si një ndër masat më ekstreme dhe me impakt të jashtëzakonshëm tek të gjithë pjesëtarët e tregut, raporti, përfshirë dhe masat e marra nga OST sh.a. përkundrejt pjesëtarëve të afektuar nga vendimarrja e OST sh.a., të miratohet nga ERE. Gjithashtu, të parashikohet që nëse ERE nuk e miraton raportin, të instruktojë OST sh.a. për marrjen e masave të tjera, përfshirë dhe kompesimin e pjesëtarëve të afektuar në mënyrë të padrejtë...
...Duke konsideruar që pezullimi i tregut nga OST sh.a. passjell dhe mospërmbushjen kontraktore të pjesëtarëve të tregut të afektuar nga kjo vendimarrje, propozojmë që në këtë nen të përcaktohen qartësisht dhe pjesëtarët dhe/ose aktivitetet që pezullohen, duke pasqyruar dhe konsiderimin e këtij pezullimi si Forcë Madhore.
...Për të garantuar ndëshkueshmërinë e pjesëtarit të tregut që mund të ketë shkaktuar pezullimin e tregut (ku dhe nëse e aplikueshme), propozojmë që OST, kostot që kanë ardhur si rezultat i pezullimit, ti rikuperojë nga shkaktari (dhe jo nga tarifa e transmetimit, siç përcaktuar në nenin 12.5).*

Shkaktari, kostot si dhe rikuperimi, të pasqyrohen qartësisht në raportin e përcaktuar në nenin 9.7 të këtyre draft rregullave.

- Rregullorja e propozuar nga OST sh.a. për të cilën nëpërmjet vendimit të bordit të ERE-s nr. 180, datë 29.05.2023, u vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e saj, plotëson kuadrin e akteve nënligjore të nevojshme për operimin e tregut të balancimit për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.
- Kodi i Transmetimit i lejon mundësinë OST sh.a. që rregullat “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullat për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”, mund të jenë të ndara ose pjesë e rregullave të tregut të balancimit që zbatohen për operimin normal të cilat tashmë janë miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020, mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
- ERE vlerëson se OST sh.a. është autoriteti i cili operon tregun e balancimit të energjisë elektrike si në kushte normale dhe në rastin kur kemi pezullim të këtij tregu. OST sh.a. përgatit raportin e përcaktuar në nenin 9 pika 7 dhe e përcjell këtë raport tek pjesëtarët e tregut dhe në ERE.
- Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nuk përcakton që ERE të realizojë procesin e miratimit të raportit të përgatitur nga OST sh.a. ndërkohë dërgimi në ERE dhe tek pjesëtarët e tregut i këtij raporti u jep mundësi si ERE dhe palëve të interesit që të bëjnë vlerësimet e tyre dhe të mbajnë qëndrimet përkatëse.
- Në rast se ndërmyet palëve të interesit lind një mosmarrëveshje ndëmyet ndonjë pjesëtarit të tregut dhe OST sh.a. duke marrë në konsideratë faktin se si pjesëtarët e tregut dhe OST sh.a., janë të licencuar kjo mosmarrëveshje mund të silltet për shqyrtim në ERE.
- Në këto rrethana vlerësojmë se miratimi i këtij raporti nga ERE është një kërkesë që nuk gjen mbështetje në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nuk zgjidh ndonjë çështje të caktuar ndërmyet OST sh.a. dhe pjesëtarëve të tregut.
- Lidhur me përcaktimin qartësisht të pjesëtarëve të tregut vlerësojmë se përcaktimi se cilët pjesëtarë tregu do të njoftohen për pezullimin e tij është një element i cili rrit përgjegjësinë e OST sh.a., trajton në mënyrë të barabartë pjesëmarrësit e tregut si dhe rrit transparencën e këtij procesi.
- Për të patur një proces gjithë përfshirës dhe për të eliminuar çdo mundësi të trajtimit të diferencuar të pjesëtarëve të tregut vlerësojmë se OST sh.a. duhet të njoftojë të gjithë pjesëmarrësit e tregut të balancimit të regjistruar në tregun e balancimit të energjisë elektrike që operohet nga OST sh.a.
- Lidhur me konsiderimin e pezullimit të tregut si Forcë madhore vlerësojmë se, ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 3 pika 16, jep përcaktimin e forcës madhore: *“Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të*

tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm”. Në këto kushte ligji 43/2015, i ndryshuar, nuk e përfshin pezullimin e tregut që trajtohet në këtë rregullore si një forcë madhore dhe për rrjedhojë kërkesa e AAES nuk mund të merret në konsideratë.

- Përcaktimi i bërë nga OST sh.a. ku propozohet se kostot që vijnë si rezultat i pezullimit të tregut të mbulohen nga OST sh.a. nëpërmjet tarifës së transmetimit nuk garanton neutralitetin financiar të OST sh.a. Duke e përfshirë OST sh.a. në mënyrë direkte në mbulimin e kostove nuk kemi një neutralitet financiar të OST sh.a., por përfshirje të OST sh.a. në këtë proces. Për rrjedhojë neni 10, pika 4, vlerësohet të ndryshojë si më poshtë vijon:

Në rast se OST sh.a. pezullon aktivitete të caktuara të tregut, OST sh.a. do të dërgojë njoftimin "Pezullimi i tregut OST sh.a." duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

- a) datën dhe orën kur aktivitetet e tregut janë pezulluar;*
- b) cilat aktivitete tregu janë pezulluar;*
- c) përditësimet për procesin e rivendosjes së sistemit të transmetimit;*
- d) vlerësimin më të mirë për kohën dhe datën e rivendosjes së sistemit të transmetimit;*
- e) informacione të tjera nëse nevojitet.*

Neni 10, pika 4, të bëhet:

Në rast se OST sh.a. pezullon aktivitete të caktuara të Tregut, OST sh.a. do të dërgojë njoftimin "Pezullimi i tregut OST sh.a." tek të gjithë pjesëtarët e tregut të balancimit të energjisë elektrike të regjistruar në OST sh.a.. Ky informacion duhet të përfshijë në mënyrë të detajuar.

- a) datën dhe orën kur aktivitetet e tregut janë pezulluar;*
 - b) cilat aktivitete tregu janë pezulluar;*
 - c) përditësimet për procesin e rivendosjes së sistemit të transmetimit;*
 - d) vlerësimin më të mirë për kohën dhe datën e rivendosjes së sistemit të transmetimit;*
 - e) informacione të tjera nëse nevojitet.*
- Alokimi i kostove në tarifën e transmetimit e cila paguhet nga të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit nuk është i drejtë pasi edhe ata përdorues që nuk janë shkaktar për pezullimin e tregut do të paguajnë për shkaktarët e këtij pezullimi, element ky që do të nxisë shkaktarët që të mos kenë kujdesin e nevojshëm pasi kostot e shkaktuara nga ata përballohen edhe nga përdoruesit e tjerë. Propozimi i ndryshimit synon alokimin e kostove tek shkaktarët e pezullimit të tregut dhe nëpërmjet llogarisë së ndarë për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut kanë pezulluar vlerësimin e neutralitetit financiar të OST sh.a. Për sa argumentuar vlerësojmë që neni 12, pika 5 të ndryshojë si më poshtë vijon:

Neni 12, pika 5, ishte: *Për të siguruar neutralitetin financiar të OST sh.a. diferenca midis shumës së të gjitha kostove të blerjes së energjisë (e gjithë energjia e injektuar nga modulet gjeneruese të enrgjisë siç përmenden në nenet 12.4 dhe 12.7 dhe sipas rastit, energjia e importuar si një rezultat i një strategjie ri-energizimi top-down) dhe shumën e të gjitha të ardhurave të shitjes së energjisë për periudhën e Dispeçerimit të Kontrolluar, siç përcaktohet në nenin 12.4 dhe 12.6 më sipër, do të rikuperohen nëpërmjet tarifës së transmetimit”.*

Neni 12, pika 5, të bëhet: *Çdo kosto që ka ardhur si rezultat i pezullimit të tregut, do të paguhet nga pjesëtarët e tregut të cilët janë shkaktar të ngjarjes që ka çuar në pezullimin e tregut. OST sh.a. do të llogarisë këto kosto duke ruajtur neutralitetin financiar të saj dhe do t'i faturojë tek shkaktarët e pezullimit të tregut. OST duhet të mbajë llogari të ndarë për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e rregullave “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar” (bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

**Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut
si dhe faturimin dhe shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancues në
rastin e pezullimit të aktiviteteve të tregut**

Neni 1

Objekti dhe Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton:
 - a) Parimet që OST duhet të ndjekë në rast se duhet të pezullojë përkohësisht një ose më shumë nga aktivitetet e tregut në përputhje me dispozitat për Procedurat për pezullimin e aktiviteteve të tregut të përcaktuara në Kodin e Transmetimit;
 - b) Procedurën që OST do të zbatojë për rivendosjen e aktiviteteve të pezulluara të tregut në përputhje me dispozitat për Procedurat për rivendosjen e aktiviteteve të tregut të përcaktuara në Kodin e Transmetimit;
 - c) Procedurën e komunikimit që OST do të zbatojë gjatë pezullimit dhe rivendosjes të aktiviteteve të tregut në përputhje me dispozitat për Procedurat e komunikimit të përcaktuara në Kodin e Transmetimit; dhe
 - d) Rregullat për faturimin dhe shlyerjen e disbalancës dhe faturimin dhe shlyerjen e kapacitetit balancues dhe energjisë balancues të cilat do të jenë të aplikueshme për faturimin dhe shlyerjen e disbalancave për periudhat gjatë të cilave aktivitetet e tregut janë pezulluar në përputhje me dispozitat për Rregullat për shlyerjet në rast të pezullimit të aktiviteteve të tregut të përcaktuara në Kodin e Transmetimit
2. Kjo rregullore dhe çdo amendim i saj miratohet nga ERE.
3. OST sh.a. mund të kërkojë/proponojë ndryshime në këto Rregulla. OST sh.a do të konsultohet për çdo ndryshim të këtyre Rregullave me palët e interesit si dhe do të ofrojë argumentimet e nevojshme për marrjen ose jo në konsideratë të qëndrimeve të palëve para dërgimit të ndryshimeve për miratim në ERE.

Neni 2

Termet dhe Përkufizimet

1. Për qëllimet e këtyre Rregullave, termat e përdorur do të kenë kuptimin e përkufizimeve të përfshira në Kodin e Transmetimit dhe kuadrin ligjor në fuqi për tregun e energjisë elektrike dhe tregun ballancues.

Për më tepër, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

‘OSSH’: Operator i Sistemit të Shpërndarjes. Aty ku OSSH përdoret në këtë dokument, duhet të nënkuptohet si operator i shpërndarjes i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

‘Kodi i Transmetimit’ është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-E.

‘Dispeçerimi i Kontrolluar nga OST’: është veprimtaria e kryer nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në të cilën përdoruesit e rrjetit ekzekutojnë pa vonesa të panevojshme udhëzimet e lëshuara nga OST.

2. Në këto Rregulla, me përjashtim të rastit kur kuptimi dikton ndryshe:
- numri njëjës përfshin numrin shumë dhe anasjelltas;
 - tabela e përmbajtjes, titujt dhe shembujt janë futur vetëm për lehtësi dhe jo ndikojnë në interpretimin e këtyre Rregullave
 - referimet në çdo legjislacion përfshijnë referimet për çdo amendim të këtij legjislacioni dhe çdo legjislacion që ka zëvendësuar atë legjislacion; dhe referimet në dokumentet ose aktet ligjore do të konsiderohen që i refohen të gjitha shtesave ose amendimeve të tyre

Neni 3

Parime të përgjithshme

- OST sh.a. duhet të sigurojë vazhdimësinë e transaksioneve të energjisë gjatë gjendjes së emergjencës, ndërprerjes së plotë/pjesëshe ose rivendosjes dhe të pezullojë veprimtaritë e tregut dhe proceset shoqëruese të tregut si një mundësi e fundit. Rregullat dhe kushtet në të cilat transaksionet e energjisë mund të pezullohen dhe rivendosen duhet të jenë të qarta dhe objektive.
- Duke pasur parasysh natyrën e jashtëzakonshme të situatave kur aktivitetet e tregut mund të pezullohen, qasja kryesore është të përcaktohen parimet e përgjithshme për procese të thjeshta dhe transparente dhe të përdoren procedurat, mjetet dhe marrëveshjet kontraktuale ekzistuese.
- Në rast se proceset dhe procedurat e reja duhet të vendosen, këto duhet të jenë të lehta dhe efikase për tu zbatuar.

Neni 4

Koordinimi nga OST sh.a.

- Në rast situatash emergjente, për të trajtuar situata të tilla në mënyrë efikase dhe efektive, OST-ja ngre ekipet e emergjencës të cilat janë ngarkuar me:
 - menaxhimin e përgjithshëm të planit të emergjencës (d.m.th. të përcaktojë strategjinë e situatës);
 - ndjekjen dhe diagnostikimin e gjendjes së rrjetit;
 - vendimmarrjen për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut;
 - vendosjen e prioriteteve për rivendosjen e lidhjes së përdoruesve;
 - vendimmarrjen për komunikimin me palët e interesuara në përputhje me procedurat e komunikimit të përmendura në Kapitullin 5 të këtyre Rregullave;
 - regjistrimin e udhëzimeve, vendimeve dhe veprimeve të ndërmarra.
- Gjatë pezullimit dhe rivendosjes së aktivitetit të tregut, OST sh.a. do të koordinojë me palët e mëposhtme:
 - operatorët e transmetimit të rajoneve të llogaritjes së kapacitetit, anëtar i të cilave është OST sh.a. dhe siç është përcaktuar në nenin 10.2 të kësaj rregullore;
 - operatorët e transmetimit me të cilat OST sh.a. ka marrëveshje për koordinimin e balancimit;
 - NEMO-t e caktuara dhe entitete të tjera të caktuara ose deleguar për të kryer funksionet e tregut brenda zonës së vetë të kontrollit;
 - operatorët e transmetimit të bllokut të kontrollit ngarkesës-frekuencës, ku OST sh.a. është anëtar;
 - llogaritësi i caktuar i kapacitetit të koordinuar të rajoneve të llogaritjes së kapacitetit ku OST sh.a. është anëtar.

3. OST sh.a. do të konvertojë situatat e referuara në dispozitat për Procedurat për pezullimin e aktiviteteve të tregut të përcaktuara në Kodin e Transmetimit në parametra të përcaktuara në mënyrë objektive. Parametrat e propozuar nga OST janë të disponueshme në aneksin e këtyre rregullave.
4. OST sh.a. do të vlerësojë në kohë reale këto parametra dhe do të marrë parasysh vonesën kohore të përcaktuar në këtë rregullore, përpara fillimit të procedurës për pezullimin e aktiviteteve të tregut. Vendimi përfundimtar i mbetet OST sh.a. përpara fillimit të pezullimit të aktiviteteve të tregut.

Neni 5

Aktivitetet e Tregut

1. Aktivitetet e tregut që mund të pezullohen nga OST janë përcaktuar në Kodin e Transmetimit nga dispozitat për Procedurat për pezullimin e aktiviteteve të tregut. Për të shmangur dyshimet, OST sh.a. nuk ka asnjë detyrim për të pezulluar të gjitha aktivitetet në treg në të njëjtën kohë, OST sh.a. ka të drejtën të vendosë se cili aktivitet tregu duhet të pezullohet sipas situatës specifike dhe për sa kohë vazhdon ky pezullim. OST sh.a. do të vendosë se cilat aktivitete të tregut do të pezullohet ose jo, në koordinim me palët përkatëse, siç është renditur në nenin 4.2.
2. Në kushtet e pezullimit të aktiviteteve të tregut OST sh.a. mund të pezullojë edhe aktivitete që kanë të bëjnë me transferimin e të dhënave nga një palë te tjetra si më poshtë:
 - a) sigurimi i kapacitetit ndërzonal për alokimin e kapaciteteve Bashkimi i Ditës në avancë në një të vetëm (Single Day Ahead Coupling) dhe/ose Bashkimi i Tregut Brenda ditës në një të vetëm (Single Intraday Coupling) në zonën përkatëse të ofertave për çdo njësi kohore të tregut ku pritet që sistemi i transmetimit të mos rivendoset në gjendje normale ose emergjence;
 - b) paraqitjen e ofertave nga Ofruesi i Shërbimeve të Balancimit (OSHB) e kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese;
 - c) sigurimi nga Pala Përgjegjëse për Balancimin (PPB) e pozicionit balancues në fund të Ditës në Avancë nëse kërkohet nga termat dhe kushtet që lidhen me balancimin;
 - d) sigurimi i modifikimeve të pozicionit të PPB-së;
 - e) sigurimin e skeduleve të gjenerimit, skeduleve të konsumit, skeduleve tregtare të brëndshme dhe skeduleve tregtare të jashtme sipas parashikimeve të Kodit të Transmetimit.
3. Aktivitetet e tjera të tregut të cilat mund të pezullohen kanë të bëjnë me:
 - a) alokimin afatgjatë të të drejtave të transmetimit;
 - b) Bashkimi i Ditës në Avancë në një të Vetëm;
 - c) Bashkimi i Tregut Brenda ditës në një të vetëm;
 - d) tregun vendas brënda ditës në platformën e NEMO brënda Zonës së Ofertimit;
 - e) prokurimi i Shërbimeve Balancuese;
 - f) publikimin e çmimit të disbalancave në faqen web të OST sh.a., vetëm në rastet e kur faqja web e OST sh.a. mund të ketë probleme teknike, mund të sjell mos publikimin e çmimit të disbalancave. Menjëherë me vendosjen funksionale të faqes web do procedohet me publikimin.

Neni 6

Masat në lidhje me Pezullimin e Aktiviteteve të Tregut

1. OST sh.a. mund të pezullojë përkohësisht një ose më shumë aktivitete të tregut kur:
 - a) sistemi i transmetimit është në gjendje blackout; ose
 - b) OST sh.a. ka ezauruar të gjitha opsionet e ofruara nga tregu dhe vazhdimi i aktivitetet të tregut nën gjendje emergjence ka të ngjarë të përkeqësojë një ose më shumë prej kushteve të referuara në Kodin e Transmetimit në lidhje me gjendjen e emergjences; ose

- c) vazhdimi i aktiviteteve të tregut do të ulte ndjeshëm efektivitetin e procesit të rikthimit në gjendjen normale ose të alarmit; ose
 - d) mjetet dhe mënyra e komunikimit të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të tregut nga OST sh.a. nuk janë të disponueshme.
2. OST sh.a. do të bëjë përpjekje të mbajë aktivitetet e tregut në funksionim sa më gjatë që të jetë e mundur duke patur në konsideratë se ato janë faktor thelbësor për funksionimin normal të sistemit.
 3. Në rast se OST sh.a. vendos për një pezullim të një ose më shumë aktiviteteve të tregut, palët e interesuara të listuara në nenin 10.2 do të njoftohen menjëherë për këtë sipas procedurës së komunikimit siç përshkruhet në Kapitullin 5 në këto Rregulla.
 4. Në rast të gjendjes së blackout, OST sh.a. do të kryejë Dispeçimin e Kontrolluar, gjatë së cilës OST sh.a. udhëzon, në bashkëpunim të ngushtë me OST-të e tjera, OSSH-të, CDSO-të, te gjithë konsumatorët e lidhur në rrjet dhe/ose për të rritur ngarkesat dhe gjenerimet e tyre (me dhe pa kapacitet black start) për të ndjekur një pikë pune të caktuar të fuqisë aktive dhe reaktive.
 5. Gjatë periudhave të Dispeçimit të Kontrolluar nga OST, ndërkohë që disa aktivitete të tregut janë pezulluar do të kërkojë nga palët që të vazhdojnë të sigurojnë, nëse është e mundur, informacion në lidhje me:
 - a) skedulimet e gjenerimit, konsumit, tregtimit të brendshëm dhe tregtimit të jashtëm;
 - b) ofertat e kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese nga OSHB;
 - c) sigurimi nga një palë përgjegjëse balancimi të pozicionit të balancës konform afateve kohor të rregullave në fuqi, nëse kërkohet nga termat dhe kushtet në lidhje me balancimin;
 - d) modifikime të pozicionit të palës përgjegjëse për balancim.

Sigurimi i këtij informacioni duhet të jepet në bazë të përpjekjeve dhe bashkëpunimit nga palët e sipërpërmendura gjatë periudhës së Dispeçimit të Kontrolluar nga OST.

6. OST sh.a. do të sigurojë disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervat e duhura në lidhje me sa më poshtë:
 - a) mjete dhe lehtësira për monitorimin e gjendjes së sistemit të transmetimit, duke përfshirë aplikacionet për vlerësimin e gjendjes dhe pajisjet për kontrollin ngarkesës-frekuencë;
 - b) mjetet për kontrollin e çelsave, çelsave zbara-lidhës ndryshuesit e ancafkave dhe pajisje të tjera që shërbejnë për kontrollin e elementeve të sistemit të transmetimit;
 - c) mjetet e komunikimit me dhomat e kontrollit të OST-ve të tjera dhe me Kordinatorët Rajonal të Sigurisë (RSC);
 - d) mjetet për analizën e sigurisë operacionale; dhe
 - e) mjetet e komunikimit të nevojshme për OST-të për të lehtësuar tregun ndërkufitar.
 OST sh.a. mund të pezullojë aktivitetet e tregut në rast se objekti kryesor si dhe ai back up një prej objekteve të mësipërme nuk është e disponueshme.

Neni 7

Rolet dhe përgjegjësitë

1. Detyrimet përkatëse të OST siç parashikohen në Termat dhe Kushtet e PPB-s pezullohen gjatë periudhës së Dispeçimit të kontrolluar të OST-së ose pezullimit të aktiviteteve të tregut, pa paragjykim ndaj detyrimeve të palëve përkatëse sipas këtyre Rregullave.
2. Në kuadër të këtyre Rregullave, konsiderohet se gjatë një periudhë të Dispeçimit të Kontrolluar të OST-së, PPB nuk është përgjegjëse për të mbajtur portofolin e saj në balancë sepse kjo mund të zvogëlojë efikasitetin për rivendosjen e sistemit të transmetimit në gjendje normale ose alerti. OST

do të qartësoj se nga cili moment PPB-ja nuk është përgjegjëse për të mbajtur portofolin e saj në balance dhe nga cili moment në kohë PPB do të jetë përsëri përgjegjëse.

3. OSSH dhe SGU të e identifikuar në zbatim të Kodit të Transmetimit, si dhe të çdo ofrues shërbimi rivendosje duhet të ekzekutojë pa vonesë udhëzimet e planit të rivendosjes të lëshuara nga OST sh.a., në zbatim të procedurave të planit të rivendosjes.

Neni 8

Llogaritja dhe shpërndarja e kapacitetit transmetues

1. Pavarësisht nga e drejta e OST sh.a. siç përmendet në nenet e sipercituara për të pezulluar disa ose të gjitha aktivitetet e tregut në kushtet e renditura:
 - a) OST sh.a. do të përpiqet të vazhdojë ofrimin e kapaciteteve ndërzonale për alokimin e kapaciteteve përmes bashkimit të ditës në avancë dhe/ose bashkimi i vetëm brenda ditës në kufijtë e zonës së ofertimit për çdo njësi kohore të tregut. Në rast se është e pamundur për OST sh.a. për të llogaritur kapacitetin ndërzonal sipas procesit dhe parimeve normale, OST sh.a. do të aktivizojë parimet e njohura të rikthimit/rezerve në mënyrë që të japë një grup vlerash rezerve të kapacitetit ndërzonal. Këto kapacitete ndërzonale rezerve mund të jenë zero MW për të gjithë kufijtë e zonës së ofertimit dhe çdo njësi kohore të tregut;
 - b) Alokimi i të drejtave afatgjata të transmetimit nuk duhet të ndikohet duke qënë se ky alokim nuk ndikon në gjendjen e sistemit. Ky aktivitet tregu mund të shtyhet për një moment të mëvonshëm në kohë pas konsultimit ndërmjet Zyrës së Përbashkët të Alokimit të Kapaciteteve dhe Operatorëve të Transmetimit përkatës.
2. Vendet që nuk preken nga ndërprerjet ose emergjencat nuk do të pezullojnë alokimin e kapaciteteve përmes bashkimit të vetëm të ditës në avancë. Në rast të ndërprerjeve ose emergjencave, OST dhe NEMO mundet që pas koordinimit ndërmjet tyre, të aplikojnë procedurat rezerve të përshtatshme të bashkimit të ditës në avancë. Bashkimi i ditës në avancë nuk duhet të përkeqësojë proceset e rivendosjes.

Neni 9

Masat e rivendosjes se Aktiviteteve te Tregut

1. OST sh.a. do të vendosë mbi rivendosjen e veprimtarive të ndryshme të tregut në përputhje me parashikimet e Kodit të Transmetimit. Disa veprimtari tregu mund të rivendosen në mënyrë sekuenciale, ndërsa disa mund të rivendosen njëkohësisht.
2. Edhe nëse është me interes të përbashkët për të rivendosur aktivitetet e tregut sa më parë të jetë e mundur, OST duhet të ketë besim të mjaftueshëm në qëndrueshmërinë e rrjetit përpara se të rivendosin veprimtaritë e tregut dhe të përfundojë faza e Dispeçerimit të Kontrolluar nga OST. OST do të marrë gjithashtu në konsideratë gadishmërinë e palëve të tregut dhe disponueshmërinë e mjeteve të komunikimit.
3. OST do të të japë përditësime mbi procesin për rivendosjen e sistemit të transmetimit në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit për procedurat e komunikimit dhe Kapitullin 5 të këtyre Rregullave.
4. OST do të rivendosë aktivitetet e tregut mundësisht në rendin në vijim:

- tregu i ditës në avancë, dhe bashkimi i tregjeve
 - skedulimit të gjenerimit, konsumit, tregtimit të brendshëm dhe tregtimit të jashtëm;
 - një pozicion të balancuar në fund të ditës në avancë, nëse kërkohet nga kushtet e lidhura me balancimin nga një palë përgjegjëse balancuese;
 - modifikimet e pozicionit të palëve përgjegjëse të balancimit;
 - kapacitetet e balancimit dhe ofertat e energjisë së balancimit nga një ofrues i shërbimit balancues, me kusht që volumet të jenë prokuruar përpara fillimit të pezullimit të tregut dhe në varësi të fisibilitetit teknik;
 - tregu i brenda ditës, dhe bashkimi i tregut brenda dites
 - publikimi i çmimit të disbalancave në faqen e internetit të OST
5. Gjatë procesit të rivendosjes OST do të vlerësojë dhe vendosë nëse sekuenca e mësipërme mund të të respektohet apo jo.
 6. Kur OST konsideron se të gjitha aktivitetet e tregut mund të rivendosen, OST do të komunikojë në kohën e duhur ose të paktën 2 orë më parë në rast të Dispeçerimit të Kontrolluar, përpara se të kthehen në tregun normal operacionet e tregtimit, në mënyrë që palët e interesuara të kenë kohë të mjaftueshme për të përgatitur kalimin nga Dispeçerimi i Kontrolluar në operacionet normale të tregut.
 7. OST do të përgatisë një raport jo më vonë se 30 ditë pas rivendosjes së veprimtarive të tregut, duke dhënë një shpjegim të hollësishëm dhe të arsyetuar, mbi zbatimin dhe ndikimin e pezullimit të tregut dhe një referencë ndaj respektimit e këtyre Rregullave dhe do t'ia paraqesë atë Entit Rregullator, si dhe ta vërë atë në dispozicion palëve të prekura dhe interesuara.

Neni 10

Procedura e komunikimit

1. OST sh.a. do të përcaktojë detyrat dhe procedurat specifike rast pas rasti në lidhje me komunikimin duke detajuar detyrat dhe veprimet e pritura nga secila palë në rolet e saj të ndryshme gjatë pezullimit dhe rivendosjes e aktiviteve të tregut.
2. Të gjitha njoftimet dhe të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteve të tregut do të dërgohen nga OST sh.a. sa më shpejt të jetë e mundur dhe njëkohësisht subjekteve në vijim:
 - Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
 - Operatorët e Mbyllur të Sistemit të Shpërndarjes (CDSOs);
 - Ofruesit e shërbimeve të rivendosjes (RSP);
 - Palët Përgjegjëse të Balancimit (PPB);
 - Operatorët e Emëruar të Tregut të Energjisë (NEMOs);
 - Autoritetit Rregullator;
 - Autoritetet Publike;
 - Ofruesve të shërbimeve balancuese (OSHB);
 - Përdorues të rëndësishëm të rrjetit (SGU);
 - Qendrës Rajonale të Sigurisë ku bën pjesë;
 - TSO-ve të rajonit të llogaritjes së kapacitetit ku OST sh.a. merr pjesë;
 - Operator i Sistemit të Transmetimit të Gazit;
 - Subjekteve të tjera përkatëse.
3. Lidhur me bashkimin e ditës në avancë dhe brenda ditës, procedurat e komunikimit duhet të dakortësohen ndërmjet OST dhe NEMO-ve përkatëse. Këto komunikime dhe mesazhe do të

vazhdojnë të dërgohen nga NEMO-të dhe/ose OST-të përkatëse siç përcaktohet nga procedurat e komunikimit të tyre gjatë periudhave të pezullimit dhe restaurimit të aktiviteteve të tregut. OST sh.a. do të mbetet në kontakt të ngushtë me OST-të dhe NEMO-të përkatëse për të diskutuar dhe vendosur për veprimet që do të kryhen nga palët e ndryshme.

4. Në rast se OST sh.a. pezullon aktivitete të caktuara të tregut OST sh.a. do të dërgojë njoftimin "Pezullimi i tregut OST sh.a." duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:
 - a) datën dhe orën kur aktivitetet e tregut janë pezulluar;
 - b) cilat aktivitete tregu janë pezulluar;
 - c) përditësimet për procesin e rivendosjes e sistemit të transmetimit;
 - d) vlerësimin më të mirë për kohën dhe datën e rivendosjes së sistemit të transmetimit;
 - e) Informacione të tjera nëse nevojitet.
5. Të gjitha njoftimet do të botohen në faqen e internetit të OST sh.a. Në rast se azhurnimi ose njoftimi nëpërmjet faqes së internetit nuk është i mundur, OST sh.a. do të kërkojë mënyrën më të përshtatshme për të komunikuar njëkohësisht me pjesëmarrësit. OST sh.a. do të ftojë palët e interesuara dhe pjesëmarrësit e tregut për t'u regjistruar paraprakisht në këto shërbime. OST sh.a., do të informojë palët në kohën e duhur rreth informacionit për regjistrim.
6. OST sh.a. do të përdorë mjetet më të përshtatshme të komunikimit për të informuar njëkohësisht të gjithë palët, të tilla si website, e-mail, whatsapp, sms, iMessage ose të ngjashme, RSS, Twitter, etj. Për marrjen e një informacioni të tillë nga palët e interesuara, kërkohet regjistrim paraprak në kanalet e dedikuara të komunikimit.
7. OST sh.a., do të dërgojë informacionin në kohën e duhur por OST sh.a., nuk do të marrë përgjegjësinë për mosfunksionimin e kanaleve të komunikimit të siguruara nga palët e jashtme kur sistemi është në gjendje blackout.
8. Njoftimi "OST Rivendosja e Tregut" do t'u dërgohet të njëjtave palë siç është përmendur në nenin 10.2 dhe do të përdorë të njëjtat kanale komunikimi si në rastin e njoftimit "OST Pezullim tregu".
9. Njoftimi "OST Rivendosja e Tregut" do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
 - a) Cilat aktivitete të tregut do të rivendosen dhe në cilën kohë;
 - b) Njoftimi se mjetet e tregut dhe sistemet e komunikimit nga palët e ndryshme janë operacionale;
 - c) Koha në ditën D-1 për paraqitjen e skedulimit, për të gjitha 24 orët e ditës D;
 - d) Data dhe ora që OST sh.a. synon të kalojë nga situata e Dispeçerimit të Kontrolluar të OST-së në funksionimin normal të sistemit të tregut në ditën D, ora H;
 - e) Informacione të tjera nëse është e nevojshme.

Neni 11

Rregullat për faturimin dhe shlyerjen e energjisë balancuese gjatë pezullimit të veprimtarive të tregut

1. Këto Rregulla duhet të:
 - a) sigurojnë neutralitetin financiar të OST sh.a. dhe të një pale të tretë përkatëse;
 - b) të shmangë stimuj kundërproduktive ndaj PPB, OSHB-ve dhe OST sh.a.;
 - c) të nxitin PPB-të të përpiqen të jenë të ekuilibruar ose të ndihmojnë sistemin për të rivendosur ekuilibrin e tij, nëse nuk zbatohet një situatë siç përshkruhet në nenin 7.2;
 - d) të shmangë çdo ndëshkim financiar të vendosur ndaj PPB-ve dhe OSHB-ve për shkak të ekzekutimit të veprimeve të kërkuara nga OST-ja;
 - e) të dekurajojnë OST të pezullojë veprimtaritë e tregut, nëse nuk është reptësisht e nevojshme dhe të nxitin OST për të rivendosur sa më shpejt veprimtaritë e tregut;

- f) nxisin OSHB-të të ofrojë shërbime për OST-në që ndihmon në rivendosjen e sistemit në gjendje normale.
2. Rregullat për faturimin dhe shlyerjen gjatë pezullimit të veprimtarisë së tregut siç përshkruhen zbatohen vetëm gjatë një periudhe të Dispeçerimit të Kontrolluar nga OST. Këto Rregulla nuk janë të zbatueshme në të gjitha situatat e tjera të pezullimit të tregut.

Neni 12

Parimet e aplikuara në rast të dispeçerimit të kontrolluar nga OST sh.a.

1. Nominimet e paraqitura në ditën në avancë për ditën e dorëzimit, siç parashikohet në Termat dhe Kushtet e PPB, dhe që janë konfirmuar nga OST sh.a., anulohen për periudhat e Dispeçerimit të Kontrolluar nga OST sh.a..
2. Gjatë një periudhe të Dispeçerimit të Kontrolluar nga OST sh.a., PPB nuk është përgjegjës për të mbajtur portofolin e saj në balancë, në përputhje me nenin 7.2, sepse kjo mund të zvogëlojë efikasitetin për të rivendosur rrjetin e transmetimit në gjendje normale. OST sh.a. duhet përcaktojë qartë nga cili moment PPB nuk është përgjegjës për të mbajtur portofolin e saj në balancë dhe pastaj nga cili moment PPB do të jetë sërish përgjegjës. Kjo nuk do të thotë se PPB lirohet nga detyrimet e saj siç përcaktohet në termat dhe kushtet e PPB duke përfshirë por pa u kufizuar në detyrimin për të disponuar mjetet e nevojshme të komunikimit.
3. Gjatë periudhave të Dispeçerimit të Kontrolluar, asnjë disbalancë nuk do të llogaritet siç është parashikuar në Rregullat e Balancimit të OST sh.a. dhe kushtet PPB.
4. Në rastin kur Përdoruesit (konsumator) i kërkohet të reduktojë ngarkesën, ai duhet të kompensohet nga OST për energjinë e reduktuar (kapacitet x kohë, të verifikuar nga SCADA dhe sistemi i matjes) me çmimin e disbalances. Në rastin kur Përdoruesit (gjenerator) i kërkohet të ulë, zvogëlojë gjenerimin, ai nuk do të jetë subjekt i disbalancës për periudhën përkatëse të aktivizimit, pra do t'i konsiderohet transaksioni i realizuar sipas nominimit përkatës. Në rastin kur i kërkohet të rrisë gjenerimin, duhet të kompensohet me çmimin e disbalancës për rritje të gjenerimit, për periudhën përkatëse të aktivizimit.
5. Për të siguruar neutralitetin financiar të OST sh.a. diferenca midis shumës së të gjitha kostove të blerjes së energjisë (e gjithë energjia e injektuar nga modulet gjeneruese të enrgjise-të siç përmenden në Nenet 12.4 dhe 12.7 dhe, sipas rastit, energjia e importuar si një rezultat i një strategjie ri-energjitizimi top-down) dhe shumën e të gjitha të ardhurave të shitjes së energjisë për periudhën e Dispeçerimit të Kontrolluar, siç përcaktohet në Nenin 12.4 dhe 12.6 me sipër, do të rikuperohen nëpërmjet tarifës së transmetimit.
6. Faturimi dhe shlyerja do të bëhet sipas rregullave në fuqi të balancimit (siç mund të jenë termat dhe kushtet e PPB ose Marrëveshja e PPB)

Neni 13

Faturimi dhe shlyerja e disbalancave gjatë procedurave të shkycjes/kufizimit automatike ose manuale të ngarkesës

1. Gjatë momenteve të procedurave të shkycjeve/kufizimeve automatike apo manuale të ngarkesës siç përcaktohet në Planin e Mbrojtjes së Sistemit të OST, pritet që veprimtaritë e tregut të mos pezullohen.
2. Në një situatë të tillë, OST do t'u dërgojë një njoftim PPB-ve dhe OSHB-ve me udhëzime për ti ndjekur, në varësi të situatës.
3. Shlyerja normale e disbalancave në përputhje me rregullat e balancimit të OST sh.a. dhe termat dhe kushtet për PPB do të zbatohen.

Neni 14

Marrëveshje kontraktuale

1. Termat dhe Kushtet për PPB dhe OSHB gjithashtu përfshijnë rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e veprimtarive të tregut dhe rregulla për zgjidhjen në rast pezullimi të tregut.
2. Pas miratimit të Rregullores nga Enti Rregullator i Energjië, Termat dhe Kushtet e përmendura në pikën 1 do të modifikohen nga OST sh.a. dhe do të dërgohen për miratim tek Enti Rregullator i Energjië sipas procedurave në fuqi.
3. Në rast se këto Rregulla kanë ndikim në marrëveshje të tjera kontraktuale ndërmjet OST sh.a. dhe ndonjë palë të interesuara, këto marrëveshje kontraktuale do të modifikohen nga OST sh.a. dhe do të dorëzohen për miratim autoritetit rregullator sipas procedurës formale.

Neni 15

Dispozita të përgjithshme

1. Zbatimi i këtyre Rregullave u nënshtrohet:
 - a) miratimin nga enti rregullator i rregullave për pezullimin dhe rivendosjen e veprimtarive të tregut dhe rregullat për faturimin dhe shlyerjen në rast të pezullimit të veprimtarive të tregut;
 - b) kordinimit eventualisht me TSO-të fqinje në lidhje me strategjinë e rienergjitimit top-down (duke përfshirë parimet e kompensimit financiar të saj) e cila do të trajtohet në marrëveshjet kontraktuale dypalëshe sapo këto Rregulla të jenë miratuar nga enti rregullator;
 - c) analizën e detajuar të ndikimit të këtyre Rregullave mbi sistemet e IT-së të OST sh.a.;
 - d) vlersimin nga OST sh.a. për kanalet më të përshtatshme të komunikimit për të informuar njëkohësisht të interesuarit gjatë pezullimit dhe rivendosjes së veprimtarive të tregut;
 - e) modifikimet e marrëveshjeve kontraktuale siç përshkruhen në kapitullin 8 të këtyre Rregullave dhe proceset e operacionale, disa prej të cilave janë subjekt i miratimit nga enti rregullator.

2. Planifikimi i përgjithshëm lidhet me zhvillimeve e përmendura më sipër, të cilat nuk janë vetëm përgjegjësi e OST sh.a. por varet dhe nga palët e tjera.
3. Një plan i detajuar zbatimi mund të krijohet vetëm në bashkëpunim me të gjitha palët pjesëmarrëse kur këto Rregulla të jenë miratuar nga Enti Rregullator. OST do të ofrojë një planifikim të tillë zbatimi 6 muaj pas miratimit nga Enti Rregullator.

Neni 16

Gjuha

1. Gjuha referuese për këto Rregulla është gjuha shqipe që do t'i paraqitet Entit Rregullator dhe do të publikohet nga OST sh.a. në faqen e saj të internetit pas miratimit nga autoriteti rregullator.
2. Një version në anglisht do të publikohet gjithashtu në faqen e internetit të OST sh.a.. Për shmangien e dyshimeve, në rast të mospërputhjeve apo paqartësive, mbizotëron versioni në gjuhën shqipe.

| Faktoret per tu konsideruar per rregullat per pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteve te tregut | | Aktivitete e tregut te cilat mund te pezullohen (dhe rivendosen) | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|--|--|---|--|---|------------|------------|---|
| | | a. sigurimi i kapacitetit nderzonal per alokimin e kapacitetit | b. paraqitja nga nje ofrues i sherbimit te balancimit te ofertave te kapacitetit te balancimit dhe energjise balancuese | c. sigurimi nga nje pale pergegjese balancimi te pozicionit balancues ne fund te afatit kohor te dites ne avance | d. sigurimi i modifikimeve te pozicionit te balances te paleve pergegjese per balancim | e. sigurimi i skedulimeve te gjenerimit, ngarkeses, tregimit te brendshme dhe tregimit te jashtem | f. aktivitete te tjera relevante pezullimi i te cilave eshte i nevojshem per te ruajtur dhe/ose rivendosur sistemin | | | | |
| a. nje perqindje e ngarkeses se shkycyr ne zonen LFC qe i korespondon: | i. paafetise ne nje mase te madhe te paleve pergegjese per balancim per te mbajtur balancen e tyre | *vazhdon pervec aktivitetit të Llogaritjes kapacitetit brenda dites, *pezullohet ne rast te ckyces se 50% te ngarkeses | *Pezullohet sapo ckycet 50% e ngarkeses; ose *Pezullohet sapo dedektohet gjendja e black out . | *Vazhdojne nominimet kur eshte e mundur, por pa u kerkuar te jene te balancuara | *Pezullohet sapo ckycet 50% e ngarkeses; ose *Pezullohet sapo dedektohet gjendja e black out | *Pezullohet vetem sigurimi i skeduleve ID sapo ckycet 50% e ngarkeses, ose *Pezullohet sapo konstatohet gjendja e black-out | *Cmimi I Disbalancave dhe ID : PEZULLOHEN *Tregu DA: Vazhdon, pervec nese Rivendosja nuk mund të arrihet as për ditën tjetër. Në kete rast Pezullohet DA nese ckycet ngarkesa me 50%; ose | | | | |
| | ii. nevoja e OST per te mos ndjekur proceset e zakoshme balancuese per te kryer nje ri-energizim eficient | | | | | | | | | | |
| b. nje perqindje e gjenerimit te shkycyr ne zonen LFC qe i korespondon: | ii. nevoja e OST per te mos ndjekur proceset e zakoshme balancuese per te kryer nje ri-energizim eficient | Pavarësisht nga përqindja e gjenerimit të shkëputur në zonën LFC, sapo të shkëputet 50% e ngarkesës (supozuar në këtë skenar), të njëjtat kritere siç u përmendën në rreshtin e mëparshëm zbatohen për çdo aktivitet tregu. | | | | | | | | | |
| | i. paafetise ne nje mase te madhe te paleve pergegjese per balancim per te mbajtur balancen e tyre | | | | | | | | | | |
| c. pjese dhe shperndarje gjeografike e elementeve te sistemit te transmetimit te padisponueshem qe i korespondon | i. desinkronizimit te nje pjese te konsiderueshme te zones LFC e cila i ben proceset e zakonshme balancuese joproductive | Pavarësisht nga pjesa dhe shpërndarja gjeografike e elementeve të sistemit të transmetimit të padisponueshëm, sapo 50% e ngarkesës është shkëputur (supozuar sipas këtij skenari), për çdo aktivitet tregu aplikohen të njëjtat kritere siç u përmendën në rreshtat e mëparshëm | | | | | | | | | |
| | ii. reduktimit ne zero te kapacitetit nderzonal ne kufijt e zonës se ofertimit | | | | | | | | | | |
| d. pafatesia e palve te prekura ne vijim per te ekzekutuar aktivitetet e tyre te tregut per arsye përtej mundësisë se tyre te kontrollit: | i. palët përgegjëse per balancim | *PEZULLOHET vetem Tregu I llogaritjes se Kapaciteteve ID nese shkëputet 50% e ngarkeses | *PEZULLOHET ne rast te ckyces se 50% te ngarkeses | Pezullohet nese 50% e PPB jane afektuar | *PEZULLOHET ne rast te ckyces se 50% te ngarkeses | PEZULLOHET nese 50% e PPB-ve jane afektuar | *Cmimi I Disbalancave dhe tregu ID : PEZULLOHEN *Tregu DA: Vazhdon, pervec nese Rivendosja nuk mund të arrihet as për ditën tjetër. Në kete rast Pezullohet DA nese ka me 50% ckycje te ngarkeses, apo menjehere sapo dedektohet gjendja e black out *Aktivitetet e tregut DA: Pezullohen nese 50% e PPB-ve ose 50% e OShB ose NEMO nuk jane ne gjendje te kryeje aktivitetet e tyre te tregut per shkaqe jashte kontrollit te tyre. | | | | |
| | ii. palët ofruese te shëbimit te balancimit | | | | | | | | | | |
| | iii. NEMO | | | | | | | | | | |
| | iv. OSSH e lidhura ne transmetim | | | | | | | | | | |
| e. mungesa e mjeteve ne funksion normal dhe mejteve te komunikimit te nevojshme per te kryer: | i. bashkemin e ditës ne avance ose brenda dites ose cdo mekanizëm te alokimit eksplicit te kapacitetit | Pezullohet | Pezullohet sapo ckycet 50 % e ngarkeses , sapo dedektohet gjendja black out | VAZHDON Palet mund të paraqesin nominime nese munden, por nuk iu kerkohej te jene të balancuar. | PEZULLOHET | Vazhdon pervec per proceset e tregut ID | Cmimi I disbalancave per DA, ID: pezullohet | | | | |
| | ii. procesin e rivendosjes se frekuences | Tregu vetem I Llogaritjes se Kapacitetit Brenda Dites nese është shkëputur 50% e ngarkeses, sapo eshte dedektuar gjendja e black out | | | | | | VAZHDON Palet mund të paraqesin nominime nese munden, por nuk iu kerkohej te jene të balancuar. | PEZULLOHET | PEZULLOHET | Cmimi I disbalancave per DA, ID: pezullohet |
| | iii. procesin e zëvendësimit te rezervës | | | | | | | | | | |
| | iv. sigurimin nga nje pale përgegjëse balancimi te nje pozicioni te balancuar ne ditën ne avance dhe sigurimi i ndryshimeve te pozicionit | | | | | | | | | | |
| | v. sigurimi i skedulimeve te gjenerimit, ngarkesës, tregimit te brendshëm dhe tregimit te jashtëm | | | | | | | | | | |